

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214/32700-26-1891-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Shërbime te mirëmbajtjes se automjeteve- LOT 1: Shërbime te mirëmbajtjes se automjeteveveturave**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH "BESI"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lidhja e Prizrenit Nr.23

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

049/123981

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

n/a

(Numri i Faks-it)

Besim Kozmaqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bkozmaqi@hotmail.com

(Adresa elektronike)



25.06.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- Njoftimi për kontrate 01.04.2026
- Proces verbali i hapjes së Tenderëve-24.04.2026
- Njoftimi për Vendimin e AK 11.06.2026
- Kriteret e Dhenies së tenderit: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët apo Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës të përshkruar në Aneksin 6

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 14.06.2026 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK, me datën 15.06.2026 pranohet vendimi nga AK ku të njëjtit bien vendim si vijon:
VENDIM .-Refuzohet të kërkesa për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime mirëmbajtjes së automjeteve" LOT 1: Shërbime të mirëmbajtjes së automjeteve-veturave me numër të prokurimit 214/32700-26-1891-2-2-1. II. Mbetët në fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK dhe letrat standarde e datës 11.06.2026 Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminimin e ofertës sonë nga procedura e prokurimit, me arsyetimin e dhënë si dhe kundër vlerësimit jo objektiv të ofertës sonë ekonomike.(shtojcë kërkesa dhe pergjegjeja)

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe

nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- *Shkelja e nenit 1-Qellimi i LPP-se të amendamentuar*
- *Shkelja e Nenit 6 – Ekoniciteti dhe Efikasiteti (LPP)*
- *Shkelja e nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP të amendamentuar*
- *Neni 56. Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave*
- *Nenin 59 Ekz. Vler. dhe Krah. i Tenderëve të LPP të amendamentuar,*
- *Shkelja e nenin 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i LPP-se*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kjo ankesë paraqitet në përputhje me nenin 109 dhe nenin 111 të Ligji për Prokurimin Publik i Republikës së Kosovës (LPP), pas refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues brenda afatit të lënë për Ankesa paraqet këtë:

ANKESË

Kundërshtojmë:

- 1. Vendimin për eliminimin e ofertës sonë;*
- 2. Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim;*
- 3. Rekomandimin për shpërbllim me kontrate një operatori ekonomik tjetër i cili është i papërgjegjshëm .*

Vendimet e lartecekura janë të nxjerra:

- **me konstatim të gabuar të gjendjes faktike;**
- **me aplikim të gabuar të së drejtës materiale;**
- **në kundërshtim me parimet themelore të LPP-së.**

Më të cilin Ankesë Ankuesi godet në tërësi Vendimin, përshkruar me lartë, si akt administrativ të paqëndrueshëm, të ngutshëm, subjektiv dhe absolutisht të pabazë dhe

Propozon që

Ankesen e paraqitur nga Ankuesi ta **miratoj** si të bazuar në Ligj, Vendimin per tenderuesin e eliminuar ta **ABROGOJ**, respektivisht, **ANULOJ** – Vendimin per shperblim me kontrate ta **Anuloj** dhe AK te **vazhdon me tutje** me proceduren e prokurimit per projektin e lartepemendur.

Vendimi është i pabazuar në fakte, në interpretim të gabuar të dokumenteve të paraqitura dhe në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, trajtimin e barabartë, transparencën dhe konkurrencën e ndershme.

NTSH “BESI”, me seli në Prishtinë, në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, brenda afatit ligjor paraqet këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Agjencia për Menaxhim Emergjent, të datës 15.06.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim si e pabazuar.

Vendimi i kundërshtuar konsiderohet i paligjshëm, i pambështetur në gjendjen faktike dhe juridike, si dhe i nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe parimet themelore të prokurimit publik.

Ankesa bazohet në:

- Konstatim të gabuar të gjendjes faktike;
- Aplikim të gabuar të dispozitave ligjore;
- Shkelje esenciale procedurale;
- Trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të operatorëve ekonomikë.

I. Shkelje procedurale gjatë vlerësimit të tenderit si jo-normalisht i ulët

Me datë 04.05.2026, AK përmes platformës e-prokurimi na ka dërguar letër standarde për sqarim lidhur me tenderin e supozuar si jo-normalisht i ulët, duke kërkuar sqarime vetëm për 11 pozicione specifike.

Me datë 06.05.2026, kompania e jone ka dorëzuar përgjigje të detajuar dhe të argumentuar për secilin pozicion, duke sqaruar:

- furnizimet e mëhershme;
- stokun ekzistues;
- politikat e brendshme të çmimeve;
- analizën teknike të automjeteve të AK-së.

Ankuesi gjithashtu ka deklaruar gatishmërinë që, në rast dyshimesh të AK-së mbi besueshmërinë e ekzekutimit, sigurimi i ekzekutimit të rritet deri në 20% ose 30% të vlerës së kontratës.

Përkundër kësaj, AK ka marrë vendim eliminues duke u bazuar edhe në pozicione të tjera për të cilat ankuesit nuk i është kërkuar asnjëherë sqarim.

Ky veprim cenon rëndë procedurën, sepse:

- *ankuesit nuk iu dha mundësi reale për mbrojtje;*
- *u cenua transparenca procedurale;*
- *u cenua e drejta për sqarim dhe kundërshtim.*

Nëse AK kishte dyshime shtesë, ishte obligim ligjor që paraprakisht të kërkonte sqarime edhe për ato pozicione.

Për rrjedhojë, vendimi eliminues është proceduralisht i paqëndrueshëm.

II. Standard i dyfishtë dhe trajtim i pabarabartë

Oferta e ankuesit:

- *Vlera e papeshuar: 42,518.00 €*
- *Vlera e peshuar: 12,255.05 €*

Oferta e OE të rekomanduar për kontratë:

- *Vlera e papeshuar: 148,064.00 €*
- *Vlera e peshuar: 38,130.85 €*

Pra, oferta fituese është rreth 3.5 herë më e lartë.

Përkundër kësaj difference ekstreme, AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim nga OE i rekomanduar.

Kjo tregon standard të dyfishtë: ofertat e ulëta janë analizuar me rigorozitet ekstrem, ndërsa oferta dukshëm më e lartë është pranuar pa asnjë analizë shtesë. Kjo bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë.

III. Analiza selektive e pozicioneve konkrete

Pozicioni 176 – Shpaneri i jashtëm i zingjirit

Ankuesi ka ofertuar:

- *Nissan Patrol 4x4 – 55.00 €*
- *Toyota Hilux – 1.00 €*
- *Golf V 1.9 TDI – 1.00 €*
- *Hyundai Santa Fe – 1.00 €*

Çmimet simbolike 1.00 € janë vendosur sepse këto automjete nuk e posedojnë fare këtë pjesë.

OE i rekomanduar ka ofertuar:

- *Nissan Patrol – 110.00 €*

- Toyota Hilux – 5.00 €
- Golf V – 5.00 €
- Hyundai Santa Fe – 5.00 €

Pra OE i rekomanduar ka përdorur logjikë identike ofertimi.

Megjithatë, për ankuesin kjo është konsideruar problem, ndërsa për OE fitues jo.

E njëjta situatë përsëritet edhe te pozicionet: 175, 186, 213 edhe shume pozicione te tjera

Kjo dëshmon qartë vlerësim selektiv dhe diskriminues.

Pozicioni 48 – Frejtë tambur mbrapa (Dobosh i frenimit)

Ankuesi ka ofertuar:

për tri automjete që nuk e posedojnë pjesën – 1.00 €

për automjetin që e posedon – 95.00 €

OE i rekomanduar:

për tri automjete që nuk e posedojnë – 75.00 € secila

për automjetin që e posedon – 10.00 €

Ky ofertim paraqet anomali teknike dhe ekonomike, pasi automjetet me sistem frenimi me disqe nuk posedojnë fare dobosh frenimi mbrapa.

Përkundër kësaj, AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim.

IV. OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret profesionale

Në FDT, neni 9.1, kërkesa 2, AK ka kërkuar:

- 3 automekanik
- 1 elektrikist për automjete

Si dëshmi dokumentare janë kërkuar:

- kontratat e punës
- kopjet e diplomave të shkollës së mesme

Pas qasjes në dokumentacionin e OE të rekomanduar është konstatuar se për pozitën e autoelektricitit nuk janë dorëzuar diploma të shkollës së mesme, por vetëm certifikata të trajnimeve/provimeve profesionale.

V. Interpretim arbitrar i FDT nga AK

FDT kërkon qartë dhe shprehimisht:

“kopjet e diplomave të shkollës së mesme”

Kjo kërkesë nuk lë hapësirë për interpretim.

Megjithatë, AK në vendimin refuzues ka konstatuar se OE fitues ka dorëzuar “diplomat, certifikimet dhe kontratat e punës konform kërkesave të FDT”.

Ky konstatim është i pasaktë.

Certifikata nuk është ekuivalente me diplomën.

AK nuk mund të ndryshojë kriteret pas hapjes së ofertave duke pranuar dokumente alternative që nuk janë kërkuar.

Nëse AK ka dashur të pranojë edhe certifikata, është dashur ta specifikojë qartë në FDT.

Pranimi i certifikatave në vend të diplomave përbën:

- **ndryshim material të kriterëve;**
- **tejkallim të diskrecionit;**
- **trajtim preferencial.**

Për rrjedhojë, OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kualifikimit.

VI. Shkeljet ligjore

Me veprimet e mësipërme, AK ka shkelur dispozitat e Ligji për Prokurimin Publik i Kosovës (LPP), veçanërisht:

- *Neni 7 – Barazia në trajtim / mosdiskriminimi*
- *Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve*
- *Neni 61 – Tenderët jo-normalisht të ulët*
- *Neni 72 – Sqarimi i tenderëve*

Vendimi i AK-së nuk mbështetet në analizë objektive dhe as në arsyetim substancial.

PROPOZIM

I propozojmë OSHP-së që:

- 1. Ta aprovojë ankesën si të bazuar;**
- 2. Ta anulojë vendimin e AK-së të datës 15.06.2026 mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;**

3. *Ta anulojë vendimin për shpërblim me kontratë;*
4. *Ta kthejë lëndën në rivlerësim në përputhje me LPP.*

I. VLERËSIMI JURIDIK:

Vendimi i AK:

- *është formalist;*
- *është joproporcional;*
- *nuk mbështetet në analizë reale;*
- *cenon konkurrencën e ndershme;*
- *krijon perceptim favorizimi.*

Eliminimi për arsye formale pa ndikim real në arsyetimin ekonomik përbën tejkalim të qëllimit të kriterit të kualifikimit.

Qëllimi i AK ka qene favorizues e jo ta zgjedh problemin ne baze te LPP.

II. ELEMENTET E FAVORI ZIMIT

Kur:

- *OE që ka ekzekutuar kontratë te tilla deri para disa ditësh eliminohet për besueshmeri te ekzekutimit edhe pse ka ofruar argumente te mjaftueshme per realizim te projektiti;*
- *diferenca ne çmim eshte e paimagjinueshme me e shtrejte se çmimi i kompanise sone si dhe me çmimet e tregut me çka krijohet dyshim serioz për:*
- *vlerësim subjektiv;*
- *trajtim selektiv;*
- *favorizim të OE të rekomanduar.*

OSHP deri me tani në praktikën e vet ka theksuar vazhdimisht se: Eliminimi për arsye formale, pa ndikim real në kapacitet apo buxhet, është joproporcional dhe në kundërshtim me parimet e LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani shumë serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*